

ADVANTAGE

THE OFFICIAL MAGAZINE OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

BIZNES - DOGANA

flasin për problematikat faqe 6-7



Sistemi i ri i regjistrimit të barnave Biznesi dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë flasin për ndryshimet

..... faqe 12

Dhoma Amerikane dhe Pricewaterhouse Coopers 'Forum Biznesi' për ndryshimet në legjislacionin fiskal

..... faqe 16



ADVANTAGE

The Official Magazine of the American Chamber of Commerce in Albania

AMCHAM BOARD



President

Mark C. CRAWFORD
*Aksioner International
Securities Brokerage*



Vice-President

Genti Daci
ABCom



Secretary

Genci LIKOSKENDAJ
*CCS Computer & Copier
Systems*



Treasurer

Alketa URUÇI
Boga & Associates

Board Members



Adrian SHEHU
T.C.N



Aleksandër SARAPULI
*Albanian-American
Enterprise Fund*



Avni PONARI
*SIGAL Uniqa Group
Austria*



Elton ÇOLLAKU
*Financial Union Tirana-
Western Union*



Julia JANECKO
*Abraham Lincoln
Foundation*



Loreta PEÇI
*PricewaterhouseCoopers
Audit*



Agim BEKAJ
Microsoft Albania



Lorenc GJONI
*Executive Director
AmCham Albania*

Publisher: AmCham Albania
Accredited with the U.S. Chamber
of Commerce in Washington

A member of the AmCham Network

Rr. "Ibrahim Rugova"
Sky Tower, Room 11-3
Tirana, Albania
Tel. +355 4 225 9779
Fax. +355 4 223 5350
info@amcham.com.al
www.amcham.com.al

Editor-in-chief
Brikena Kamenica

English section
Andi Balla

Albanian section
Fotini Harispapa

Design & Layout
Eyes Advertising



ADVANTAGE

Të nderuar anëtarë

Dhoma Amerikane ju fton të shfrytëzoni hapsirat publicitare te revistës së saj
"The Advantage"

Revista vjen tek ju si një prej botimeve më unike mes organizatave të biznesit.

"The Advantage" ju ofron tarifa konkurruese dhe një treg të sigurtë

Me "Advantage" ju shfaqeni kudo

Bizneset më të mëdha në vend dhe rajon,
Institucionet Publike dhe Parlamenti,
Trupi Diplomatik,
Institucionet Ndërkombëtare,
Organizatat e biznesit,
Aeroporti "Nënë Tereza",
Hotelet kryesore

Për më tepër informacion kontaktoni në :
Dhoma Amerikane e Tregëtisë në Shqipëri
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, 113
Tirana, Albania
Tel: +355 4 225 9779
Fax: +355 4 223 5350
E-mail: info@amcham.com.al
Web: www.amcham.com.al





ADVANTAGE

The Official Magazine of the American Chamber of Commerce in Albania

SUSTAINING MEMBERS

				
				
				
				
				
				
				
				
				
				

ANETARE PRESIDENCIALE

				
				
				
				
				
				
				
				
				



AMCHAM MEETINGS

The American Chamber of Commerce held its annual meeting with the Customs Director and other representatives on February 10th, 2016, continuing the tradition of facilitating open discussion between business and customs authorities to nurture a stable working relationship between them. In his opening remarks, the President of AmCham, Mr. Mark Crawford, expressed his appreciation for the continued cooperation with Customs, evident in recent actions with which Customs leaders showed their readiness to take quick actions to address concerns expressed by businesses importing from the United States.

During the meeting, AmCham Board member, Ms. Alketa Uruçi, listed some of the concerns that the Chamber has received from its members, including the negative effects of using reference prices, related VAT reimbursement problems that arise from application of those prices, and limits placed on hours of operation for exports.

The General Director of



AmCham organizes Business Forum with Customs Directorate

Customs, Ms. Pranvera Fagu, listened carefully to all the concerns raised by the American Chamber and addressed several of them. She pointed out that in 2015 only 11% of imports cleared customs using reference prices, and the Customs administration is working

to lower this percentage in 2016. During this year, they also intend to bring online the electronic database that will offer complete information for businesses.

Another novelty for 2016 is the electronic customs declaration that

will be enabled by the online portal. All these innovations aim to improve the quality of service for business, to make procedures easier, and lower costs for business.

During the rest of the meeting, AmCham members discussed openly the concerns they have encountered during their work with Customs and received explanations from the relevant directors and technical experts of the Customs administration.

TAKIMET E AMCHAM



Dhoma Amerikane Forum Biznesi me Drejtësinë e Doganave



Dhoma Amerikane e Tregtisë ka organizuar takimin e përvitshëm me doganat duke vazhduar traditën e diskutimit të hapur mes biznesit dhe stafit të doganave për të zhvilluar një marrëdhënie të qëndrueshme pune mes tyre. Gjatë takimit Presidenti i Dhomës Amerikane Mark Crawford ka vlerësuar bashkpunimin me doganat dhe gadishmërinë që ata kanë shfaqur për tju përgjigjur

në kohë cështjeve dhe shqetësimeve që ka Dhoma Amerikane.

Gjatë takimit anëtarja e Bordit të Amcham Alketa Uruci ka përmendur disa nga shqetësimet që Dhoma ka marrë prej anëtarëve dhe që prekin nga referencat dhe problem i rimburimit të TVSH – së nga ana e tatimorëve e deri tek ndryshimi i orareve të cdoganimit për eksportuesit që ju ka shkaktuar vonesa dhe kosto këtyre bizneseve.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave Pranvera Fagu ka dëgjuar me vëmendje të gjitha cështjet e ngritura nga Dhoma Amerikane dhe i është përgjigjur një pjesë të mirë të tyre. Cmimi i referencës sipas znj Fagu është përdorur vetëm në 11 për qind të rasteve në 2015 dhe tentojnë të ulen akoma në 2016 kohë gjatë të cilës do të krijohet dhe database elektronik ku do të jetë informacion i plotë për bizneset.

Një tjetër risi për 2016 do

të jetë deklarimi elektronik që do tju mundësohet të gjitha bizneseve nëpërmjet portalit on line. Këto risi teknologjike synojnë të përmirësojnë pikërisht cilësinë e shërbimit për bizneset por dhe të lehtësojnë procedurat dhe kosto doganore.

Anëtarët e Dhomës Amerikane kanë diskutuar hapur gjatë takimit për të gjitha shqetësimet që kanë hasur gjatë punës së tyre në dogana dhe kanë marrë përgjigje nga stafi teknik i kësaj drejtorie.



AMCHAM MEETINGS

1 The application of reference prices continues to be a concern for AmCham members. This procedure leads to additional costs for the business (in the form of additional customs taxes paid), but also creates liquidity problems (due to paying VAT on the reference price to the Customs administration). Besides this, AmCham members operating as exporters are facing another cost. Being exporters, these taxpayers end up with a credit balance of VAT, for which they request reimbursement. In recent years, the Tax administration has adopted a new stance, according to which, the amount of VAT that comes from the application of reference prices may be offset by VAT on sales within the country, but may not be directly reimbursed. Although this stance is in contradiction of the law on VAT, it penalizes businesses who pay VAT at customs but cannot recover the amount they have paid.

2 The Order of GDC to limit the hours during which export declarations may be completed in the interior customs offices for exit through Durrës customs creates obstacles and additional costs for taxpayers. Limiting the time of customs service increases parking costs, transportation costs, damages from the breach of contractual obligations to foreign customers, etc.

3 AmCham members have raised concerns regarding the need for reconciliation of payments/prepayments made at customs branches before 2013 (when payments were not connected to specific accounts). After 2013, payments made into accounts for the customs administration can be identified more easily. Therefore, the intervention of the customs administration is needed, to make a general reconciliation with customs branches for the credit balances of all taxpayers with respect to the customs administration, otherwise these credit balances remain on paper (unusable).

4 The concern raised by businesses in general, as well as by AmCham members, about paying the scanning fee twice, both at the port of entry and at the final customs clearance with the local office, has been addressed by the government, but no solution has been offered about the additional costs that business incurred during the 4-month period when they had to pay the fee twice.

Issues treated during the meeting with Custom Directory



TAKIMET E AMCHAM

Problematikat e trajtuara në takimin me Drejtorinë e Doganave



1 Aplikimi i çmimeve reference. Vazhdon ende të jetë shqetesim për anetaret e Dhomes. Kjo procedure sjell kosto shtese për biznesin (sa i takon pageses shtese të takses doganore) por krijon edhe probleme likuiditeti (për shkak të pageses prane administrates doganore të TVSH mbi referencën). Përveç kësaj, anetaret e Dhomes që operojnë si eksportues janë duke u përballur edhe me një kosto tjetër. Duke qenë eksportues, këta tatimpagues rezultojnë në vijimesi me tepricë kreditore të TVSH, për të cilën kërkojnë rimbursim. Vitet e fundit administrata tatimore ka marrë një qëndrim të ri sipas të cilit, shumën e TVSH-se që vjen nga aplikimi i çmimeve të referencës të lejon ta netosh me TVSH e shitjeve brenda vendit por refuzon ta rimbursojë. Megjithatë është një qëndrim në kundërshtim me ligjin për TVSH, kjo penalizon bizneset të cilët e paguajnë TVSH në doganë por nuk mund ta rikuperojnë atë shumë që kanë paguar.

2 Urdhëri i DPD për limitimin e orareve brenda të cilit duhet të kryhen deklaratat e eksportit në zyrtat doganore të brendshme me zyre doganore dalese Durrësin, krijon pengesa dhe kosto shtese për tatimpaguesit. Kufizimi i kohës së shërbimit doganor rrit kostot e parkimit, kostot e transportit, dëm nga mospermbushje e detyrimeve kontraktore kundrejt klienteve të huaj etj.

3 Anetaret e Dhomes kanë ngritur shqetesime lidhur me nevojën për rakordimin e pagesave/paradhenieve të kryera prane degeve doganore përpara vitit 2013 (kur pagesat nuk ishin të identifikueshme në një llogari). Nga viti 2013 e mërzat, pagesat e derdhura në llogari për administratën doganore mund të identifikohen me lehtë. Pra, ka nevojë për nderhyrjen e administrates doganore për të bërë një rakordim të përgjithshëm me deget doganore për shumatat e kredise së të gjithë tatimpaguesve kundrejt administrates doganore, përndryshe këto kredi do të mbeteshin në lehtë (të papërdorshme).

4 Shqetesimi i ngritur nga bizneset në përgjithësi për edhe anetaret e Dhomes Amerikane për pagesat e dyfishta të tarifës së skanimit në rastet e tranzitit u adresua nga qeveria, por ende nuk ka një zgjidhje lidhur me atë kosto shtese që pati biznesi për periudhën 4 muajore kur u detyrua të paguante në mënyrë të dyfishtë.



AMCHAM MEETINGS

Tax and Legal Committee meet representatives of the Investment Council

The Tax and Legal Committee discussed with representatives of the Investment Council the ideas on how problems and disagreements between businesses and government entities can be resolved within the administrative jurisdiction.

Investment Council representatives and at the same time EBRD experts have explained the purpose of the meeting and how the Investment Council has worked during this time in order to address crucial issues of business activity. Some of these issues have been tax processes, informality and now administrative solutions.

Members of the Permanent Group of the Tax and Legal committee shared their opinions and comments on how administrative solutions work today, particularly in the areas of tax and customs, and how they should function based on best practices, with the aim of reducing administrative barriers to business.

According to AmCham representatives, the appeals process should work in every institution, Customs, Tax, the Ministry of Environment, the Ministry of Labor, and so on, though the largest influx of complaints is in the tax sector.

At this time, it would be valuable to discuss the return of the Appeals Directorate, which operated until 2008 within the Ministry of Finance, and which had in its composition Tax representatives, Ministry of Finance representatives, independent experts, and business representatives. This Directorate was the last link to examine an appeal in the tax sector and its work had a lot of success. Such an integrated structure should resume its function.

AmCham experts have sought to have well-defined procedures for the adjudication of development or administrative issues. It would be a good thing for tax appeal hearings to be recorded. Also the Administrative Courts have a large case load and should be relieved from the burden of ruling on civil matters which can be passed back to District Courts, thus improving the response from Administrative Courts. Another necessary component is the regular evaluation of the work of the inspectors as well as of the judges and their rulings.



TAKIMET E AMCHAM

Takim i Komitetit të Taksave dhe Ligjeve me përfaqësuesit e Këshillit të Investimeve



Komiteti i Taksave dhe i Ligjeve ka diskutuar me përfaqësuesit e Këshillit të Investimeve ide të mundshme mbi mënyrat se si mund të zgjidhen problematikat dhe mosmarrëveshjet midis biznesit dhe administratës brenda juridiksionit administrativ.

Përfaqësuesit e Këshillit të Investimeve, të cilët ishin dhe ekspertë të BERZH-it kanë shpjeguar qëllimin e këtij takimi dhe mënyrën se si Këshilli i Investimeve është munduar gjatë kësaj kohe të trajtojë çështje me rëndësi themelore për aktivitetin e biznesit. Disa nga këto çështje të trajtuara kanë qenë proceset tatimore, informaliteti dhe tashmë edhe zgjidhjet administrative.

Anëtarët e Grupit Permanent të Komitetit të Taksave dhe të Ligjeve kanë sjellë opinionet dhe komentet e tyre mbi mënyrën se si funksionon sot zgjidhja administrative, sidomos në sektorin e tatimeve dhe të doganave dhe si duhet të funksionojë mbështetur në praktikë më të mira dhe mbi qëllimin e reduktimit të pengesave administrative për biznesin.

Sipas përfaqësuesve të Dhomës në çdo institucion duhet të funksionojë sektori i apelimit duke filluar nga doganat, tatimet, Ministria e Mjedisit, e Punës e me radhë edhe pse fluksi më i madh i ankimeve është tek sektori i tatimeve.

Merr vlerë në këtë kohë që të diskutohet rikthimi i Drejtorisë së Apelitit që ka funksionuar deri në 2008-ën brenda Ministrisë së Financave dhe që ka pasur në përbërje të saj përfaqësues të tatimeve, të Ministrisë së Financave, ekspertë të pavarur dhe një përfaqësues të biznesit. Kjo drejtori ka qenë hallka e fundit që shqyrtonte ankimimin në sektorin e tatimeve dhe ka patur rezultat. Një strukturë e tillë duhet të rivihet sërish në funksion.

Ekspertët e Dhomës Amerikane kanë kërkuar që të ketë procedura të mirëpërcaktuara për zhvillimin apo gjykimin e çështjeve administrative. Do të jetë një gjë e mirë nëse seancat e apelimit tatimor të inçizohen. Gjykata Administrative duhet të çlirohet nga çështjet civile, të cilat mund të kalohen sërish në Gjykatën e Faktit, duke i dhënë më shumë mundësi zgjidhjes së çështjeve administrative. Gjithashtu, është kërkuar të bëhet vlerësim edhe për punën e inspektorëve, ashtu sikurse edhe për vendimet që japin gjykatësit.



NEW MEDICAMENT REGISTRATION SYSTEM



Business and representatives of the Ministry of Health talk about changes

The American Chamber organized a roundtable between senior officials of the Ministry of Health who cover the pharmaceutical sector and industry representatives, members of AmCham. Discussions focused on the electronic system for registering new medicaments for import and distribution, and on the impact of technological changes in this market.

The Ministry of Health was represented by Ms. Alma Skënderi, Director of the National Agency of Medicaments and Medical Equipment, Ms. Shpresa Bello, Director of the Pharmaceutical Directorate of the Ministry of Health, and Mr. Tomi Thomo, Director of Health Advancement, Quality Assurance and Priorities Attainment. They provided

useful information in the form of a presentation that included a recorded walkthrough of the new system, highlighting the changes that the system is undergoing, how new medicaments will be recorded, and how this will affect the implementation of electronic invoicing. A pilot of the new system, with electronic invoicing and online registration of medicaments in the Drug

Register, is currently in progress in Durrës and is expected to be extended throughout the country.

AmCham members asked several questions about the way that the system will work to ensure the correct registration of every detail of the medicaments so that all necessary information is available through the system. Questions and discussions also explored how the new system provides solutions

to several issues related to prescriptions covered by the Mandatory Health Insurance Fund.

The meeting of representatives of the Ministry of Health with AmCham members from the pharmaceutical sector was considered very useful by the participants who agreed to a second meeting, which will serve to increase information exchange and cooperation between them.

SISTEMI I RI I REGJISTRIMIT TË BARNAVE

Biznesi dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë flasin për ndryshimet

Dhoma Amerikane ka organizuar një tryezë pune me drejtues të lartë të Ministrisë së Shëndetësisë që mbulojnë sektorin e farmaceutikës dhe përfaqësues të kësaj industrie, anëtarë të Dhomës Amerikane. Në qendër të diskutimit ka qenë sistemi i ri on-line i regjistrimit të barnave dhe impaktet e ndryshimeve të reja teknologjike në këtë treg.



Përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë kanë qenë znj. Alma Skënderi, Drejtore e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, znj. Shpresa Bello, Drejtore e Drejtorisë së Farmaceutikës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe z. Tomi Thomo, Drejtor i Drejtorisë së Përpunimit Shëndetësor, Kontrollit të Cilësisë dhe

Jetësimit të Prioriteteve. Ata kanë informuar nëpërmjet një materiali të përgatitur të gjitha ndryshimet që do të pësojë sistemi, si do të regjistrohen medikamentet me sistemin e ri dhe si do të operohet me faturën elektronike në përfundim të tij.

Një sistem pilot i aplikimit të faturës elektronike dhe regjistrimit on-line të medikamentit në regjistrin e barnave, ka filluar në Durrës dhe pritet që të shtrihet në të gjithë vendin.

Anëtarët e Dhomës Amerikane kanë patur mjaft pyetje për mënyrën se si do të funksionojë sistemi për të regjistruar me korrektësi çdo detaj të medikamentit, në mënyrë që i gjithë informacioni i duhur të jenë on-line. Mjaft pyetje dhe diskutime ka patur dhe për mënyrën se si sistemi i ri i jep zgjidhje shumë çështjeve që vijnë nga faturat me rimbursim.

Takimi i përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë me anëtarë të sektorit të farmaceutikës është konsideruar mjaft interesant dhe pjesëmarrësit janë treguar të gatshëm për një raund të dytë takimi, që do t'i shërbejë informacionit dhe rritjes së bashkëpunimit mes palëve.





2015 / PARTY

AmCham Celebrates the Holiday Season with its members

The American Chamber of Commerce celebrated with grandeur the end of the year, with 200 guests, including members of the Chamber, members of the Board, and guests from the U.S. Embassy: Deputy Ambassador David Muniz, Economic Officer Don Brown, and Political Officer Peter D'Amico.

Guests were welcomed by the Vice President of AmCham, Mr. Gent Daci who recalled the most important moments of the year and wished all the members a Happy New Year and success in facing all challenges.

Deputy Ambassador Muniz also wished all participants "Gëzuar Vitin e Ri" after expressing his appreciation for all the continuous collaboration between the US Embassy and the American Chamber of Commerce and the mutual aid they offer each other.

The evening was accompanied by great performances from singer Era Rusi, violoncellist Iljard Shaba and the orchestra from Shkodra, as well as by a raffle in which guests could win wonderful prizes offered by AmCham members. The Gala Event of this year was organized in the framework of activities for the 15th Anniversary of AmCham, concluding a year where every element has echoed this jubilee.



2015 / FESTA

AmCham feston me anëtarët FESTAT E FUNDVITIT



Dhoma Amerikane ka festuar me madhështi Festat e Fundvitit në praninë e 200 anëtarëve, Bordit të Dhomës Amerikane dhe Zëvendësambasadorit Amerikan, z. David Munitz, Atasheut Ekonomik, Donald Brown dhe Atasheut Politik, Peter D'Amico.

Mbëmjen e kanë përshëndetur Zëvendës-presidenti i Dhomës Amerikane, z. Gent Daci, i cili ka kujtuar momentet më të rëndësishme të vitit në Dhomën Amerikane dhe i ka uruar të gjithë anëtarë një vit të mbarë dhe realizim me sukses të të gjitha sfidave.

Një përshëndetje të ngrohtë u drejtoi të gjithë pjesëmarrësve dhe Zëvendësambasadori David Munitz, i cili ka vlerësuar bashkëpunimin që Ambasada Amerikane ka me Dhomën Amerikane dhe ndihmën e ndërsjellë që i japin njëri-tjetrit, duke i uruar në fund shqip të gjithë anëtarë "Gëzuar Vitin e Ri".

Mbrëmja ka pasur shoqërinë e emrave të njohur të muzikës si këngëtarja Era Rusi, violonçelisti Iljard Shaba, orkestra e muzikantëve nga Shkodra si dhe surprizat e dhuratave të mëdha. Mbrëmja Gala e këtij viti u organizua edhe në kuadrin e aktiviteteve të 15 vjetorit të Dhomës Amerikane, duke përmbyllur një vit ku çdo element i ka bërë jehonë vitit jubile.





PRICE MEETING



Business Forum

with PricewaterhouseCoopers (PwC) Albania about Changes in the Fiscal Package

AmCham and PricewaterhouseCoopers Organize a Business Forum about Changes in the Fiscal Package

The American Chamber of Commerce in Albania and PricewaterhouseCoopers (PwC) Albania organized a Business Forum on "Informing Taxpayers on Tax Legislation" that focused

in training business about what they need to know about their relationship with the tax authorities from the moment of registering at the NRC (National Registration Center), until the time comes to close the business and deregister.

Experts from PwC explained in detail all key elements necessary for developing a business: the registration at the NRC, fiscal cash registers, issuing fiscal coupons and fiscal receipts in various approved formats, tax levels according to business size, and the steps to follow to close out a business.

The training was followed with great interest from a considerable number

of AmCham members, who also expressed their need for similar training to continue in 2016. In her opening remarks, Ms. Loreta Peçi, Country Director of PwC Albania, talked about the importance of staying informed of changes in the tax legislation and procedures. This Forum is part of the PwC Albania initiative in collaboration with the government of Albania to inform businesses on these topics.

TRAJNIMI ME PRICE



Dhoma Amerikane dhe Pricewaterhouse Coopers Forum Biznesi për ndryshimet në legjislacionin fiskal

Dhoma Amerikane dhe Pricewaterhouse Coopers 'Forum Biznesi' për ndryshimet në legjislacionin fiskal

Dhoma Amerikane e Tregtisë në bashkëpunim me Pricewaterhouse Coopers, organizoi Forumin e Biznesit "Informimi i Tatimpaguesve mbi Legjislacionin Tatimor", i

cili u fokusua në trajnimin e biznesit me informacione të nevojshme që nga momenti i regjistrimit të një biznesi në QKR deri në çregjistrimin e tij.

Ekspertë të Pricewaterhouse Coopers shpjeguan

në detaje të gjithë elementët kyç në zhvillimin e biznesit, regjistrimin në QKR, kasat fiskale, kuponat tatimorë dhe të gjitha llojet e faturave tatimore, nivelin e taksave sipas biznesit dhe elementet që duhet të ndjekësh për regjistrimin e biznesit.

Trajnimi u ndoq me mjaft interes nga një numër i madh anëtarësh të Dhomës Amerikane, të cilët shprehën

nevojën që këto formate trajnimesh duhet të vazhdojnë edhe gjatë 2016-ës. Duke folur gjatë Forumit të Biznesit, Loreta Peçi, Drejtore e Pricewaterhouse Coopers, foli mbi rëndësinë që ka informacioni mbi ndryshimet ligjore. Ky Forum ishte pjesë e inisiativës që Pricewaterhouse Coopers ka ndërmarrë në bashkëpunim me qeverinë shqiptare për të informuar biznesin.



MEMBER NEWS



LINCOLN CENTERS OF ALBANIA

Abraham Lincoln Foundation

Abraham Lincoln Foundation of Albania (www.lincolnalbania.org) announced that Aida Repishti will lead the trusted not-for-profit education services provider. She succeeds Gordon Schrank as the President of Abraham Lincoln Foundation, also known as the Lincoln Centers of Albania.

Robb Provost, Chairman of the Board of Directors, remarked, "Aida's character and values reflect those of the board and the organization. She will do a great job of leading the staff as we seek to serve our clients with professional excellence. Few understand better our mission and vision than Aida. She is an exceptional leader. We are very privileged to have her as president."

Mrs. Repishti comes with a wealth of experience in running the Lincoln Centers. Since the organization's inception in 1997, Mrs. Repishti has opened each new location. Historically, she managed day-to-day operations for Lincoln. Over the past few years, she has held increasingly strategic

roles in the organization.

Most recently, Mrs. Repishti served as the Executive Vice President of Lincoln where she oversaw community and government relations, new market development, and strategic planning.

In her promotion to President, Mrs. Repishti looks to continue the Abraham Lincoln Foundation's history of excellence in delivering Lincoln's trusted education services to individual students and to results-driven companies in Albania. Mrs. Repishti comments, "I am thankful to work with the Lincoln board and our phenomenal team to serve my people as our nation continues to develop and have impact in our region and world."

Added Mr. Provost, "Mr. Schrank added tremendous value to the organization with his years of customer service and leadership development expertise. He and his wife Carol were a blessing to everyone who they met. Gordon was generous to give us 2 years in the latter years of his working career. We wish them well as they go."



ANTEA Cement

The Company ANTEA Cement, part of TITAN Group, has delivered the Social Responsibility and Sustainability Report for the year 2014. This is a global tradition for large corporations and in Albania it has been introduced for the first time. The report has identified the financial, environmental, social performance and governance of the company for the year 2014. This activity coincides with the 5 year anniversary of ANTEA Cement operation in Albania.

This event was attended by the General Manager of ANTEA Cement Mr. Adamantios Frantzis, senior representatives of ANTEA Cement, the Executive Director of the Institute for Corporate Governance Mrs. Rezarta Cenaj, ambassadors accredited in Tirana, such as Ambassador of Switzerland Mr. Christoph Graf, Ambassador of Greece Mr. Leonidas Rokanas, the International Finance Corporation (IFC) Representative in Albania Mrs. Elira Sakiqi, the Audit Manager at Ernst

& Young Albania, Mr. Donard Braha, etc.

During his speech, Mr. Frantzis thanked the participants for their presence in the event and gave a short presentation on the objectives of the company, bringing to their attention the company's usage of the highest standards in providing occupational safety, environmental protection, social issues, protection of human rights, as well as application of anti-corruption practices.

"We are committed and aim at ensuring quality products for our customers, creating satisfactory working conditions and high standards for our employees, by offering real opportunities for development, respect for human rights and above all ensuring maximum safety at work. We are committed to respect and protect the environment by using the best techniques available. We are committed to strictly implement the law by using anti-corruption practices in all our business transactions", said the General Manager of ANTEA Cement.

LAJME ANËTARËSH



Fondacioni Abraham Lincoln

Fondacioni Abraham Lincoln ne Shqipëri (www.lincoln.albania.org) njoftoi se Aida Repishti do të udhëheqë organizaten jo fitim prurëse të shërbimeve të arsimit. Ajo pason Gordon Schrank si President i Abrahamit Lincoln Foundation, i njohur gjithashtu si Qendrat Lincoln në Shqipëri.

Robb Provost, Kryetar i Bordit të Drejtorëve, u shpreh, "Karakterit dhe vlerat e Aides pasqyrojnë ato të bordit dhe të organizatës. Ajo do të bëjë një punë të madhe për të udhëhequr stafin ndërkohë që kërkojmë të shërbejmë klientëve tanë me përsosmëri profesionale. Pak e kuptojnë misionin dhe vizionin tonë sic ben Aida. Ajo është një udhëheqëse e jashtëzakonshme. Ne jemi shumë të privilegjuar që ta kemi presidenten."

Zonja Repishti vjen me një përvojë të çmuar në drejtimin Qendrave Lincoln. Që nga fillimi e veprimtimit të organizatës në vitin 1997, znj. Repishti ka qenë themeluese e cdo qendre të re. Historikisht, ajo ka menaxhuar veprimtarinë e perdritshme të qendrave Lincoln. Gjatë disa viteve të fundit, ajo ka mbajtur role gjithnjë e më strategjike në këto organizatë. Kohët

e fundit, zonja Repishti ka shërbyer si Zëvendës Presidente Ekzekutive e Qendrave Lincoln, detyrë gjatë të cilës ajo mbikqyri marrëdhëniet me komunitetin dhe qeverinë, zhvillimet e reja në treg, dhe planifikimin strategjik.

Në promovimin e saj për President, Znj Repishti dëshiron vazhdojë historinë e Fondacionit Lincoln Abraham në përsosmërisë e ofrimit të shërbimeve arsimore për të cilat shume nxënës i kanë besuar Qendrave Lincoln rezultatet e punës të të cilëve i ndajnë dhe shumë kompani të tjera në Shqipëri. Komenteti i Zonjes Repishti: "Unë jam mirënjohëse dhe e lumtur që punoj me bordin Lincoln-it dhe ekipin tonë fenomenal për të shërbyer popullit tim ndërkohë që kombi ynë vazhdon të zhvillohet dhe të fillon të ketë ndikimin e tij në rajon dhe në botë."



Antea Cement

Kompania Antea Cement, pjesë e Titan Grup prezantoi Raportin e Integruar të Përgjegjësisë Sociale dhe Qëndrueshmërisë për vitin 2014, traditë globale kjo e korporatave të mëdha, e që në Shqipëri vjen për herë të parë. Në raport evidentohet performanca financiare, mjedisore, sociale dhe e qeverisjes së kompanisë për vitin 2014. Aktiviteti koinçidon edhe me 5 vjetorin e operimit të Antea Cement në Shqipëri. Në këtë event të organizuar nën kujdesin e Antea Cement morën pjesë punonjës të kompanisë, përfaqësues të pushtetit vendor, klientë, agjenci qeveritare si dhe përfaqësues të institucioneve të huaja.

Drejtoresha Ekzekutive e Institutit për Qeverisjen e Korporatave, Znj. Rezarta Cenaj, ambasadorët e akredituar në Tiranë, si Ambasadori i Zvicrës, Z. Christoph Graf, ambasadori i Greqisë, Z. Leonidas Rokanas, Përfaqësuesja e Korporatës Financiare Ndërkombëtare, Znj. Elira Sakiqi, Menaxheri i Audit pranë Ernst & Young Albania, Z. Donard Braha përshëndetën iniciativën e Antea Cement për të adresuar një raport të tillë. Gjatë fjalës së tij, z. Frantzis falenderoi të pranishmit për prezencën e tyre ndërsa bëri një prezantim të shkurtër të objektivave të kompanisë,

duke sjellë në vëmendje nga përdorimi i standardeve më të larta në ofrimin e sigurisë në punë, mbrojtjen e mjedisit, çështjeve sociale, mbrojtjen e të drejtave të njeriut e deri tek aplikimi i praktikave të anti korrupsionit. "Ne jemi të angazhuar dhe synojmë garantimin e produkteve cilësore për konsumatorët, krijimin e kushteve të mira të punës dhe standarde të larta për punonjësit tanë, duke ofruar mundësi të vërteta zhvillimi, respektimin e të drejtave të njeriut e mbi të gjitha duke garantuar siguri maksimale në punë. Jemi të angazhuar në respektin dhe mbrojtjen e mjedisit, duke përdorur teknikat më të mira të mundshme. Ne jemi të angazhuar në zbatimin me përpikmëri të ligjit duke përdorur praktikën e anti korrupsionit në të gjitha transaksionet tona të biznesit" u shpreh Drejtori Ekzekutiv i Antea Cement.

Z. Frantzis shprehu besimin se një mjedis i tillë biznesi do të ndihmojë Shqipërinë në thithjen e investimeve cilësore, duke ndikuar në prosperitetin dhe përparimin e shoqërisë. Aktiviteti u moderua nga Drejtoresha Ekzekutive e Institutit për Qeverisjen e Korporatave, z. Rezarta Cenaj. Ajo vuri në dukje rolin pozitiv të Antea Cement përsa i përket Përgjegjësisë Sociale, ofrimit të kushteve të mira dhe oportuniteteve reale për komu-



MEMBER NEWS

Mr. Frantzis expressed his confidence that such a business environment will help Albania to attract qualitative investment, affecting the prosperity and progress of society. The Conference was also welcomed by the Executive Director of the Corporate Governance Institute Mrs. Rezarta Cenaj, who emphasized the positive role of ANTEA Cement regarding Social Responsibility, provision of good conditions and real opportunities for the community, the environment and other social issues. Ambassador of Switzerland to Tiranë Mr. Christoph Graf complemented ANTEA Cement for its performance and contribution as well as expressed his high assessment of the report. He added that this should be an example for other businesses to follow.

"I am very happy to be here with you and being introduced with this report, which I am confident it will encourage other companies to improve their reporting standards. The Corporate Governance Institute and the International Finance Corporation are ready to support companies in this regard", said Mr. Graf. The Ambassador of Greece to Albania Mr. Leonidas Rokanas said: "I feel privileged to take

part in this event, which has demonstrated and showed us how such a large enterprise can achieve continued success in the service to customers, community and beyond, by working with will and commitment. ANTEA Cement should be proud of what it has achieved and has given the country these years, and I hope that this path will be followed by many other companies."

The IFC representative Mrs. Elira Sakiqi emphasized the importance of Corporate Social Responsibility and said that the report that has been introduced should be a guide for other corporations and enterprises. She positively praised the events that ANTEA has organized during these years. The event was also welcomed by the Audit Manager at Ernst & Young Mr. Donard Braha. In addition to the presentation of the methodology used for auditing this report he said that this is the first Social Responsibility and Sustainability Report audited in Albania.



Starting February 1st, ABC Health will offer the possibility of a Free Health Fair to Albanian Corporations as a way to increase awareness about work-related health issues. The screening will include measuring: blood pressure, pulse, height/weight to determine BMI, and blood glucose for all the employees that participate. After this initial screening a family doctor will talk about healthy lifestyle, diet, physical activity and family medicine. Our Family Health Center is also available to offer health education seminars for interested companies' headquarters, on all matters of health protection, avoiding work related injuries and work safety.

These opportunities are offered to the members of AmCham to care for their employees as their most precious asset, helping them improve their health and work productivity. For employees, taking care of personal health is often a challenge amidst competing demands of the work day, family responsibility, and other social obligations. Improved health can reduce

out-of-pocket expenses for physician office visits, medications, procedures or hospitalizations related to acute or chronic illness.

Employers with healthier employees will spend less on direct medical costs, worker compensation and disability costs, replacement costs for ill or injured workers who are absent, and costs for recruiting and training new workers. Furthermore, healthier employees are more productive and innovative in their work. The ABC Family Health Center offers the best primary health care in Albania since 1994. Our multi-national senior physicians, physiotherapists, and nurses are committed to treat patients according to the best western practices, treating patients with respect, dignity and confidentiality.

Companies interested to organize one of these events are encouraged to submit a written request to the ABC Family Health Center one month before the seminar. If you have any questions, don't hesitate to contact us. (healthcenter@abchealth.org, www.abchealth.org)

LAJME ANËTARËSH

nitetin, mjedisin dhe çështje të tjera sociale. Komisioni European duke nisur nga viti 2017 do të mandatojë raportimin e performancës jo fitim prurëse të kompanive të mëdha. Në këtë kontekst, nisma e Antea-s për të adresuar një raport të tillë do të shërbejë si një praktikë e mirë për kompanitë e tjera të mëdha që operojnë në vend.

Një vlerësim të veçantë për punën dhe kontributin e Antea Cement si dhe prezantimin e këtij raporti e shprehu edhe Ambasadori i Zvicrës në Tiranë, Z. Christoph Graf, i cili theksoi se ky duhet të jetë një shembull për t'u ndjekur edhe nga bizneset e tjera. Qeveria e Zvicrës i jep një rëndësi të veçantë përmirësimit të praktikave të raportimit dhe qeverisjes së korporatave në vendet në tranzicion, e veçanërisht në Shqipëri duke mbështetur programet që promovojnë dhe përmirësojnë standardet dhe praktikat e qeverisjes së korporatave.

“Jam shumë i lumtur të jem këtu pranë jush dhe të shoh prezantimin e këtij raporti, i cili jam besimplotë se do të nxisë kompanitë e tjera që të përmirësojnë standardet e tyre raportuese. Instituti i Qeverisjes së Korporateve dhe IFC janë të gatshme që të mbështesin kompanitë në këtë drejtim” u shpreh z. Graf. Nga ana e tij, ambasadori i Greqisë në vendin tonë, z. Leonidas Rokanas tha: “Ndihej i privilegjuar të marr pjesë në këtë aktivitetet, i cili dëshmoi dhe na tregoi se si një sipërmarrje e madhe me vullnet dhe angazhim mund të shënojë arritje pas arritje në shërbim të konsumatorëve, komunitetit dhe jo vetëm. Antea

Cement duhet të jetë krenare për çka ka arritur dhe i ka falur vendit këto vite, dhe unë shpresoj shumë që këtë rrugë të ndjekin edhe shumë sipërmarrje të tjera”. “Jam krenar që Antea Cement është një investim grek, siç edhe ju e dini Greqia është një nga investitorët kryesorë të Shqipërisë duke patur rreth 25 % të investimeve të huaja në vend, duke ardhur gjithnjë e në rritje. Nuk ka metodë më të mirë për të ndjekur për t'u bërë lider se sa sjellja e shembujve. Dhe mënyra më e mirë për ta arritur këtë, janë metodat përmes raporteve të integruara.

Filozofia e Titan, raporti që u prezantua sot, këto vlera që kompania mbart, sjellin një shembull brilant, në përgjithësi për shoqërinë, e për bizneset në këtë vend. Ka shumë biznese në këtë vend që janë shumë inovative, shumë pak njerëz e dinë, por shpresoj se ne do të kemi mundësi, bashkë me Titan dhe me Bashkimin European në pak muaj të organizojmë një event me shumë të rëndësishëm, i cili do të prezantojë pikërisht këto shembuj brilantë nga vendi juaj, ashtu si edhe ky shembull për të cilin ne jemi duke folur sot, çka do të frymëzojë organizimin e aktiviteteve ekonomike dhe prosperitet në botën e biznesit në Shqipëri” u shpreh ndër të tjera ambasadori Rokanas. Zonja Elira Sakiqi nga IFC (Korporata Financiare Ndërkombëtare) ndërsa vuri theksin tek rëndësia e Përgjegjësisë Sociale të Korporateve, bëri të ditur se Raporti i Intergruar i prezantuar sot duhet të jetë një udhërrëfyes edhe nga

korporatat e sipërmarrjet e tjera. Ajo vlerësoi me nota pozitive aktivitetet e zhvilluara nga Antea gjatë këtyre viteve. Aktivitetin e përsëritet edhe Menaxheri i Auditimit tek Ernst & Young, z. Donard Braha. Në kuadër të prezantimit të metodologjisë së përdorur në auditin e këtij raporti, ai konfirmoi se ky është raporti i parë për Përgjegjësinë Sociale që auditohet në Shqipëri.



Duke filluar nga 1 shkurti, Qendra Shëndetësore ABC do të ofrojë falas mundësinë e një panairi shëndeti pranë korporatave si mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin për shëndetin në vendin e punës. Panairi përfshin një kontroll të përgjithshëm për punonjësit, i cili përbëhet nga matja e tensionit të gjakut, pulsit, peshës dhe gjatësisë për të caktuar BMI, dhe matje të glukozës në gjak. Pas këtij testi fillestar, një Mjek Familjeje do të flasë rreth dietës, aktivitetit fizik dhe mjekësisë së familjes.

Qendra Shëndetësore ABC është gjithashtu e gatshme të ofrojë seminare edukative në zyrat qendrore të kompanisë së interesuar, për të gjitha çështjet e mbrojtjes së shëndetit, shmangien e aksidenteve dhe sigurinë në punë. Këto mundësi i jepen antarëve të Dhomës Amerikane të Tregëtisë për

t'u kujdesur për punonjësit e tyre si aset në më të çmuar, duke i ndihmuar ata për të përmirësuar shëndetin dhe produktivitetin në punë. Për punonjësit, kujdesi për shëndetin personal mund të jetë i vështirë për shkak të ngarkesës në punë, përgjegjësiwe familjare dhe angazhimeve të tjera sociale. Përmirësimi i shëndetit mund të sjellë përfitime ekonomike, duke ulur shpenzimet mjekësore për vizita, medikamente, apo procedura që trajtojnë sëmundje akute apo kronike.

Punëdhënësit që kanë punonjës në të shëndetshëm shpenzojnë më pak për benefitet shëndetësore, kompensimin e punonjësve, për zëvendësimin e tyre kur mungojnë dhe për rekrutimin dhe trajnimin e punonjësve të rinj. Për më tepër, punonjësit e shëndetshëm janë më produktivë dhe inovativë në punën e tyre. Qendra Shëndetësore ABC ofron shërbimin më të mirë mjekësor parësor në Shqipëri që nga viti 1994. Ekipi ynë ndërkombëtar i mjekëve, infermierëve dhe fizioterapistëve është i përkushtuar për të dhënë kujdes mjekësor bazuar në praktikën më të mirë perëndimore, duke trajtuar pacientët me respekt, dinjitet dhe konfidencialitet.

Kompanitë e interesuara për të organizuar një nga këto evente janë të lutura të bëjnë një kërkesë për Qendrën Shëndetësore ABC të paktën një muaj para datës së seminarit. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi të na kontaktoni! healthcenter@abchealth.org www.abchealth.org

